



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Rektori
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1107
Dt 25.07.2018

Në bazë të nenit 28 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës, në koordinim me sekretarin e përgjithshëm të UMIB – it, marr këtë:

V E N D I M

Lidhur me shfrytëzimin e pushimit vjetor kolektiv për personelin akademik dhe administrativ të universitetit për vitin 2018

- I. Pushimi vjetor për të gjithë personelin akademik dhe administrativ të Universitetit të Mitrovicës do të shfrytëzohet nga data 30.07.2018 deri më 24.08.2018 (20 ditë pune).
- II. Kthimi në punë nga pushimi vjetor do të bëhet me datë 27.08.2018.
- III. Përjashtim nga paragrafi I i këtij vendimi do të bëhet për personelin të cilëve, sipas ligjit në fuqi, iu takojnë më së shumti 18 ditë pune të pushimit vjetor.
- IV. Personeli që i takon kategorisë si në paragrafin III të këtij vendimi, pas shfrytëzimit të ditëve të pushimit vjetor, do të rikthehet në punë.
- V. Personeli administrativ që pjesërisht e ka shfrytëzuar pushimin vjetor të vitit 2018, pjesën e mbetur të pushimit mund ta shfrytëzojë vetëm për ditët që i takojnë sipas ligjit.
- VI. Personeli administrativ, të cilëve sipas ligjit iu takojnë më shumë se 20 ditë pune pushim vjetor, mund t'i bartë në vitin tjetër maksimalisht dymbëdhjetë (12) ditë pune të pushimit vjetor të pashfrytëzuar. Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor mund të shfrytëzohen më së largu deri në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm kalendarik.
- VII. Dekanët dhe sekretarët e njësive akademike do të kujdesen që gjatë pushimit kolektiv, të caktojnë një zyrtar që do të kryejë shërbime për studentët në çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00.
- VIII. Sekretari i njësisë përkatëse akademike është i obliguar që për secilin nëpunës administrativ të lëshojë vendim individual për periudhën e shfrytëzimit të pushimit vjetor për vitin 2018.
- IX. Udhëheqësi i zyrës së personelit është i obliguar që për secilin nëpunës administrativ të AQ të lëshojë vendim individual për periudhën e shfrytëzimit të pushimit vjetor për vitin 2018.
- X. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Menaxhmentit të UMIB – it;
2. Sekretarit të përgjithshëm;
3. Dekanëve dhe sekretarëve të njësive akademik;
4. Drejtorëve të AQ;
5. Arkivit të UMIB – it.

Prof. asoc. dr. Alush Musaj
Rektor